



BASHKIA MIRDITË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 3604/2 Prot

Rrëshen më, 30 . 09 . 2024

V E N D I M

Nr. 79 datë 25. 09. 2024

PËR
“PËRDORIM FOND REZERVË - DHËNIE NDIHMË FINANCIARE”,
BASHKIA MIRDITË.

Në mbështetje të ligjin nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", në ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", në ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017, "Për financat e vetëqeverisjes vendore", në ligjin nr. 97/2023, "Për buxhetin e vitit 2024", në Udhëzimin nr.9, datë 20.07.2018, "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit", Udhëzimi nr.1, datë 24.01.2024, "Për zbatimin e buxhetit e vitit 2024", në VKB nr. 50, datë 15.12.2023, "Për miratimin e buxhetit të vitit 2024", relacionin nr. 3500 prot, datë 17.09.2024, "Mbi vlerësimin ekonomik – social të familjes të Z.Mark Gjon GJINI", nga sektori i shërbimit social të bashkisë, së bashku me projektin e Kryetarit bashkisë, shqyrtuar në mbledhjen e datës 23.09.2024, në mbledhjen e Komisionit Ekonomisë, Financave dhe Buxhetit, pas diskutimeve në mbledhjen e këshilli bashkiak;

V E N D O S I:

1. Të miratojë përdorimin e fondit rezervë, në shumën **50 000**, (pesëdhjetë mijë) lekë, për dhënie ndihmë financiare, si vijon;
 - ✦ T'i akordohet ndihmë financiare familjes së Z.Mark Gjon GJINI, fshati Malaj, njësia administrative Rrëshen, për sëmundje të rëndë e kushte të vështira jetese.
 - a. **Paksim:** Fondi rezervë;(A1133 00 2133001 01 V491AAA...604) në vlerën;.....**50 000** lekë.
 - b. **Shtohet:** Pagesë;(AA133 00 2133001 01 V111AAA...606) në vlerën;.....**50 000** lekë.
2. Pagesa të kalojë në emër të kryefamiljares Z. Mark Gjon GJINI, mbajtës i kartës identitetit G50425049S, në degën e Postës Mirditë, zyra Postare Rrëshen.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i bashkisë Mirditë, (drejtoria e zhvillimit ekonomik dhe tatim taksat).

Ky vendim, hyn në fuqi, sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar.

SEKRETAR

Gaspër TOPOLLAJ

email:bashkia@bashkiamirdite.gov.al



KRYETAR

Aleksandër PICAËU

tëel dhe fax: (00355) (0) 2162233

www.bashkiamirdite.gov.al



BASHKIA MIRDITË

KËSHILLI I BASHKISË MIRDITË

Nr. 3604/Prot

Datë 24/09 / 2024

P/V E N D I M
Nr. 89 date 24. 9 .2024

“PËR PERDORIM FOND REZERVË ”

Mbështetur në ligjin 139/2015 " Për vetëqeverisjen vendore", në ligjin Nr. 9936 date 26.06.2008 " Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", në ligjin nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", në ligjin nr.97/2023, "Per buxhetin e vitit 2024" "Udhëzimin Nr.9 datë 20.07.2018 "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit", në udhëzimin nr.1, datë.24.01.2024, "Për zbatimin e buxhetit 2024", ,ne VKB nr.50 datë 15.12.2023 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2024", në relacionin, nr.3500prot, datë.19.09.2024, "Mbi vlesimin e situates financiare dhe sociale te z.Mark Gjon Gjini" e sektorit të shërbimit social, Bashkia Mirditë, këshilli i bashkisë Mirditë pasi diskutoi rreth projektit të paraqitur nga Kryetari i bashkisë;

V E N D O S I:

I-Të perdorë nga fondi Rezerve shumën 50 000 lekë, për dhënie ndihmë financiare si më poshte;

1.Të japë ndihmë financiare, z. Mark Gjon Gjini, NJA Rreshen, për kushte të vështira jetese dhe sëmundje e rëndë.

a-Paksim:fondi rezervë (AA133 00 2133001 01 V491AAA..604) për shumën ***50 000 lekë***

b-Shtohet (AA133 00 2133001 01 V111AAA.....606) për shumën ***50 000 lekë***

.2.Pagesa te kaloje ne degen e Postes Mirdite, zyra Postare Rreshen.

II-.Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.

III-.Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

SEKRETARI
Gaspër TOPOLLAJ

KRYETARI
Aleksander PICAKU

Paraqiten projektin

Dr./zhvill ek dhe tatim taksat:: V.Gjoka

Dr.Juridike, prok, protokoll: B. Dedaj

KRYETARI
Albert MËLYSHI

ADRESA: SHESHI "ABAT DOÇI", RRESHEN

email:bashkia@bashkiamirdite.gov.al tel dhe fax : (00355) (0) 222162223www.bashkiamirdite.gov.a





K Bashkia

BASHKIA MIRDITË

AGJENCIA E ARSIMIT SPORTIT DHE NDIHMËS SOCIALE

Nr. 3500 Prot.

Rrëshen, më 17.07.2024

Lënda: Relacion mbi familjen Mark Gjon Gjini

Drejtuar: Kryetarit të Bashkisë Mirditë Z. Albert Mëlyshi dhe Këshillit të Bashkisë Mirditë

Më 10.07.2024, një ekip i Shërbimit Social, i përbërë nga përgjegjësi i sektorit social Gjergj Përgjoni dhe dy administratorët e sektorit social, Fabjola Dodaj dhe Roza Preçi realizuan një vizitë tek familja Gjini në Malaj. Kjo familje përbëhet nga pesë anëtarë: prindërit, dy vajza (njëra e martuar) dhe një djalë. Të ardhurat e kësaj familjeje vijnë nga NE, ku përfitojnë shumën prej 9129 lekë të reja, shumë tepër e vogël, për të përballuar kërkesat e familjes.

Prej vitit 2019, familja jeton në kontejner, në kushte totalisht të papërshtatshme higjieno-sanitare. Familjes i është kërkuar të transferohet në Rrëshen tek shtëpitë e projektit të tërmetit, por kryefamiljari nuk ka pranuar dhe ka kërkuar që shtëpia t'i ndërtohet në Malaj. Jemi në vitin 2024 dhe familja Gjini jeton ende në kontejner.

Kjo familje përballlet me shumë vështirësi, një vështirësi tjetër ka të bëjë me gjendjen shëndetësore të kryefamiljarit, Z. Mark Gjon Gjini, me ID G50425049S, i cili është i paafte për punë dhe ka nevojë për shoqërues, pasi mezi qëndron në këmbë.

Duke parë gjendjen e mjerueshme socio-ekonomike të kësaj familjeje, si Shërbim Social e vlerësojmë të domosdoshëm ofrimin e ndihmës për të, për këtë i drejtohem Kryetarit të Bashkisë Mirditë Z. Albert Mëlyshi dhe Këshillit të Bashkisë Mirditë që të bëhet i mundur transferimi i familjes Gjini në Rrëshen, ku t'i gjendet një shtëpi me qera, e cila do të mund të paguhet me bonusin e qerasë.

Konceptoi: Adela Gjikota 

Miratoi: Drejtori Aurel Çupi 

Përgjegjës i Sekt. Soc. Gjergj Përgjoni 

ADRESA: SHESHI "ABAT DOÇI", RRËSHEN

email: bashkia@bashkiamirdite.gov.al

tel dhe fax : (00355) (0) 2162233

www.bashkiamirdite.gov.al